



**Nr. 2408/12 K (e-k) Prot.**  
**Tiranë, më datë 03/08/2024**

**Drejtuar:** Komisionit Qendror të Zgjedhjeve  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
z. Ilirjan CELIBASHI

**Lënda:** **DENONCIM Nr. 2** – Lidhur me  
thyerjen e heshtjes zgjedhore nga  
disa media.

**I Nderuar Z. Komisioner!**

**Të nderuar Kolegë të Administratës së KQZ-së!**

Kodi Zgjedhor, në nenin 77 “Periudha e fushatës dhe heshtjes zgjedhore”, në pikën 1 dhe 2 përcakton se: “1. Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve. 2. Dita përpara datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve, deri në orën e mbylljes së votimit, formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore nëpërmjet organeve të medias, si dhe zhvillimi i mitingjeve ose i veprimtarive të tjera zgjedhore të subjekteve zgjedhore.”

Lidhur me këtë dispozitë, KRIIK monitoroi në mënyrë të rastësishme transmetimet e disa mediave audiovizive paraditen e sotme të datës 3 gusht 2024, në ditën e heshtjes zgjedhore.

Nga ky monitorim rezultoi se televizionet Klan News, Ora News dhe CNA TV, transmetuan sot në edicionet e tyre të lajmeve, kronikën e takimeve të zhvilluara një ditë më parë në funksion të fushatës elektorale, nga kandidati i Partisë Socialiste në Bashkinë Himarë dhe kryetari i kësaj partie z. Edi Rama. (Gjeni në fund të këtij denoncimi printscreen-et e këtyre transmetimeve).

Sa më sipër rezulton në shkelje të ligjit prej nga rrjedh edhe **detyrimi i KQZ-së për të vepruar e marrë masa** sipas parashikimeve të nenit 174 pika 2 të Kodit Zgjedhor.

Nga ana tjetër, referuar edhe faktit që kjo sjellje është një shkelje e përsëritur nga ana e mediave, në gjykimin e KRIIK, **nevojitet që KQZ-ja, jo vetëm t'i marrë në konsideratë dhe shqyrtojë këto shkelje,**

**por edhe të bëjë sa më parë një Njoftim Publik dhe një Kujtesë për respektimin e heshtjes zgjedhore,** duke iu kujtuar të gjitha mediave, në veçanti atyre lokale, se asnjë aktor publik, qoftë ky edhe një organ mediatik, nuk është mbi ligjin.

Madje KQZ-ja duhet ta shtrijë këtë njoftim, si një sqarim të nevojshëm, edhe **për subjektet zgjedhore dhe partitë politike,** se heshtja zgjedhore vlen edhe për ta **duke ndaluar çdo aktivitet elektorale që ka si target zgjedhësit e Bashkisë Himarë,** pasi Kodi Zgjedhor parashikon qartë se gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, pra gjatë ditës së sotme dhe deri nesër në ora 19.00 kur mbyllet orari i votimit, ndalohet *zhvillimi i mitingjeve ose i veprimtarive të tjera zgjedhore të subjekteve zgjedhore.*

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

**Gjykohet dhe nxitet KQZ, të komunikojë në vazhdimësi me këto media, dhe me të tërë mediat në vend, si edhe me AMA-n, për të informuar mbi këtë ndalim.**

Gjithashtu, **nevojitet të ndërgjegjësohen mediat për të ndaluar publikimin edhe të retorikës politike** që mund nxitet prej aktorëve politikë gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, apo edhe ri-publikimin e retorikës së ditëve të mëparshme, **pasi në thelb ato përbëjnë fushatë zgjedhore të cilat ndikojnë apo orientojnë votën e zgjedhësve.**

Në linjë me ruajtjen e heshtjes zgjedhore dhe referuar përvojave të hasura në zgjedhjet e mëparshme, KRIIK evidenton se në ditën e zgjedhjeve **subjektet zgjedhore kanë praktikën të vijnë reklamën me pagesë, qoftë në faqe interneti, qoftë në mediat sociale apo në mediat e tjera online.**

KRIIK gjykon se është me vend dhe **nxit KQZ-në ta shqyrtojë këtë fenomen duke e konsideruar këtë lloj reklame në çdo platformë online të njëvlefshme me reklamën e ndaluar në mediat audio-vizive, si dhe ta përfshijë ndalimin e saj në Njoftimin Publik që i propozohet.**

Në përfundim, të këtij denoncimi KRIIK sjell në kujtesën tuaj se Kodi Zgjedhor parashikon periudhën e heshtjes zgjedhore si një periudhë në të cilën **qytetarët shqiptarë nuk duhet të ndikohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë rast nga propaganda elektorale, në çdo formë dhe mjet me të cilën mund të shfaqet e transmetohet ajo.**

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

**Me konsideratë,**

***Për Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)***

**Premto Gogo  
Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

## SHTOJCË

### Printscreen-et e transmetimeve në shkelje të heshtjes zgjedhore

#### TV Klan News



Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania





**TV ORA News**



Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
 Nd.4, H.2, Ap.3,  
 Nj.Adm.5,  
 Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396  
 Tirana, 1001,  
 Albania

## TV CNA



**CNA**  
City News Albania

09:38  
03/08/24

**Kronika**  
**e fundit**

**NË PRANGA I RIU**  
09:32

**Gjatë aksionit janë sekuestruar 232 doza me lëndë të dyshuar narkotike cannabis sativa, gati për shitje**

**AKUZAT E PD**  
Rama: Unë kam trashëguar 1 pronë, studion e tim eti

**Restorant Berlin**  
Adresa: Rr. Jul Variboba, No. 04, Tiranë  
facebook.com/RestorantBerlin  
Shërbim Taxi: 04 22 60 737

**BERLIN**  
RESTAURANT PIZZERIA

@citynewsalbania



**CNA**

09:40  
03/08/24

**Kronika**  
**e fundit**

**NË PRANGA I RIU**  
09:32

**Policia ka arrestuar një 33-vjeçar me initiale A. Gj, pasi shpërndante drogë në zona të ndryshme të Tiranës**

**AKUZAT E PD**  
Rama: Unë kam trashëguar 1 pronë, studion e tim eti

**KrikKraK**  
Adresa: Rr. Prush Vaqarr, Tiranë  
fb: @krikkrak.al, lg: @krikkrak.al  
email: info@alsi.al  
+355 69 26 77 177

**ALSI & CO shpk**

+355 68 900 9999

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania